



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.30, datë 19.12.2024



PËR

**RINOVIMIN E LEJES ME NR.45 PROT., DATË 23.7.2018 DHËNË ME
VENDIM NR.33/2 DATË 13.7.2018 NGA KBU SHKUMBIN
“PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME
INDUSTRIALE”,
SUBJEKTIT “GSA”SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes me nr.115/1, datë 15.1.2208 dhënë me vendim 7 datë 27.12.2019 nga KBU Shkumbin për “Përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale” subjektit “GSA”sh.p.k me vendndodhje Njësia Administrative Papër Elbasan Qarku Elbasan:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- $X= 500552.4$; $Y= 4550080.6$; $Z= 100$ m.m.n.d
- Prurja e kërkuar: $Q= 0.007$ m³/s



3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

ALI MYSLIU

